



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.20, datë 04.06.2024

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
"GODINË POLIFUNKSIONALE "CITY HOTEL", 12 KATE+ATIK MBITOKË DHE 4  
KATE NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË RRUGEN BRIGADA E VIII, BASHKIA  
TIRANË"

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Z. Agim Zeqo, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: "Godinë Polifunksionale "City Hotel", 12 kate+atik mbitokë dhe 4 kate nëntokë, me vendndodhje në Rrugën "Brigada VIII", me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues Z. Agim Zeqo, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 09, datë 23.10.2019.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 68, datë 27.07.2022 "Për miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit për objektin: "Godinë polifunksionale "City Hotel", 12 kate+atik mbitokë dhe 4 kate nëntokë, me vendndodhje në Rrugën Brigada VIII, Bashkia Tiranë", nuk ndryshojnë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.


KRYETARI  
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENËRGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 14/06/2024